



BULETIN MUJOR

MARS 2025



PËRMBAJTJA

- Investime, teknologji dhe qëndrueshmëri: Qasja e Shqipërisë në CyberSec 2025
- AKSK forcon bashkëpunimin rajonal përmes WB3C
- SimSpace në shërbim të sigurisë: trajnim i avancuar për institucionet kritike
- Trajnim i avancuar për studentët më të mirë në sigurinë kibernetike
- Edukim digjital për të moshuarit: Siguria kibernetike për të gjithë
- Rrjeti 5G dhe sfidat kibernetike: zgjidhje përmes bashkëpunimit

Investime, teknologji dhe qëndrueshmëri: Qasja e Shqipërisë në CyberSec 2025



Në konferencën ndërkombëtare CyberSec 2025 në Romë, Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, Igli Tafa, prezantoi përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e sigurisë kibernetike përballë kërcënimeve rajonale dhe ndërkombëtare. Ai theksoi nevojën për një strategji të përbashkët evropiane dhe përf forcimin e partneriteteve në funksion të qëndrueshmërisë digjitale.

Z. Tafa u ndal te sfidat e epokës digjitale, duke përmendur rëndësinë e teknologjive si intelijenca artificiale dhe informatika kuantike. Sipas tij, siguria digjitale është thelbësore për mbrojtjen e qytetarëve, stabilitetin ekonomik dhe integritetin kombëtar.

AKSK forcon bashkëpunimin rajonal përmes WB3C

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike priti një delegacion nga Franca, Sllovenia dhe Mali i Zi, në kuadër të një vizite mbi bashkëpunimin me Qendrën për Ndërtimin e Kapaciteteve Kibernetike në Ballkanin Perëndimor (WB3C). Si koordinator kombëtar i kësaj nisme, AKSK ka lehtësuar trajnimin e punonjësve të administratës publike dhe do të vijojë të mbështesë iniciativat rajonale në këtë drejtim.

Delegacionet u njohën nga afër me Qendrën e Operacioneve të Sigurisë (SOC) dhe laboratorët e specializuar të AKSK. Vizita konfirmoi angazhimin e Shqipërisë për të ndarë ekspertizën dhe për të forcuar bashkëpunimin në fushën e sigurisë kibernetike në nivel rajonal.



Address : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



@aksk.gov.al



+355 422 21 039



SimSpace në shërbim të sigurisë: trajnim i avancuar për institucionet kritike

AKSK organizoi një trajnim praktik për rritjen e kapaciteteve mbrojtëse të infrastrukturave kritike dhe institucioneve të pavarura, duke përdorur platformën SimSpace – një mjet i avancuar për simulimin e sulmeve kibernetike dhe testimin e strategjive mbrojtëse në kushte reale, por të kontrolluara.

Ky trajnim synoi përgatitjen e specialistëve për të përballuar më mirë kërcënimet në rritje në hapësirën digjitale. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me First Cyber Security & Engineering Solutions dhe me mbështetjen e DCAF.

Trajnim i avancuar për studentët më të mirë në sigurinë kibernetike

AKSK vijon mbështetjen për të rinjtë e talentuar në fushën e sigurisë kibernetike, duke organizuar një trajnim të avancuar me platformën SimSpace për studentët më të spikatur nga universitetet. Pjesëmarrësit patën mundësinë të përfitojnë eksperiencë praktike me simulime reale të sulmeve dhe menaxhimit të incidenteve.

Ky trajnim është pjesë e përpjekjeve për të formuar brezin e ri të ekspertëve të sigurisë digjitale dhe për të fuqizuar kapacitetet vendase. Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me First Cyber Security & Engineering Solutions dhe me mbështetjen e DCAF.



Edukim digjital për të moshuarit: Siguria kibernetike për të gjithë

AKSK zhvilloi aktivitete informuese për të moshuarit në Qendrat Ditore në Durrës dhe Tiranë, me fokus në ndërgjegjësimin mbi mashtrimet online dhe mbrojtjen në hapësirën digjitale. Të moshuarit janë ndër grupet më të ndjeshme ndaj skemave mashtruese, ndaj rritja e dijes mbi përdorimin e sigurt të internetit është thelbësore.

Kjo nismë synon të fuqizojë çdo grupmoshë për t'u përballur me sfidat e botës digjitale. Aktivitetet u realizuan me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Rrjeti 5G dhe sfidat kibernetike: zgjidhje përmes bashkëpunimit

AKSK organizoi një workshop mbi sigurinë kibernetike në rrjetin 5G, duke sjellë në vëmendje rëndësinë e një qasjeje të bashkërenduar mes autoriteteve dhe kompanive të telekomunikacionit. U trajtuan tema si korniza rregullatore evropiane dhe shqiptare, menaxhimi i incidenteve dhe përdorimi i "5G Toolbox".

Drejtori Igli Tafa theksoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit konkret me sektorin e telekomunikacionit, për të garantuar një mjedis digjital të sigurt. Aktiviteti u pasurua me kontributin e ekspertëve ndërkombëtarë dhe u mbështet nga MIE, AKEP dhe projekti Cyber Balkans i financuar nga BE.

